

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

STRATEGJIA PËR SIGURIMIN E CILËSISË

2023 – 2028¹

¹ Miratuar me Vendim Senati Nr. 15, datë 23/12/2022



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



PËRMBAJTJA

HYRJE	2
1.1. Qëllimi dhe baza ligjore	2
1.2. Vizioni dhe misioni i institucionit	2
POLITIKA PËR SIGURIMIN E CILËSISË	3
2.1. Objektivat strategjike	3
2.2. Parimet e menaxhimit të cilësisë	3
2.3. Standardet e sigurimit të brendshëm të cilësisë	4
STRUKTURAT E SIGURIMIT TË CILËSISË	5
3.1 Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë	6
3.2 Akreditimi dhe sigurimi i jashtëm i cilësisë	7
FUSHA DHE QASJE TË VLERËSIMIT NË KUADËR TË SIGURIMIT TË CILËSISË	8
VEPRIMTARI MONITORIMI, VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI	9
PËRDORIMI I REZULTATEVE	10
KOMUNIKIMI DHE PUBLIKIMI I REZULTATEVE	10
HARTIMI DHE NDRYSHIMI I STRATEGJISË PËR SIGURIMIN E CILËSISË	10

HYRJE

Universiteti European i Tiranës (UET) është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në Shtator, 2006 (VKM Nr. 636, datë 20.09.2006) dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore që zbatohen në fushën e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. UET ofron programe studimit në të tre ciklet e studimit, si dhe programe të studimit me karakter profesional, në fushat dhe nëndisiplinat; shkenca ekonomike, shkenca juridike, shkenca sociale e politike, shkenca humane e arte të aplikuara, shkenca inxhinierike e të teknologjisë së informacionit, shkenca mjekësore.

Veprimtaria e UET mbështetet nga strukturat akademike dhe administrative të tij, sipas detyrave dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të funksionit të tij. Universiteti European i Tiranës, i kushton rëndësi të veçantë sigurimit të cilësisë, në të dy komponentët e këtij procesi - sigurimit të brendshëm dhe sigurimit të jashtëm të cilësisë. UET e ndërton veprimtarinë e tij për sigurimin e cilësisë bazuar në Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë (në vijim edhe; Strategjia SC).

1.1. Qëllimi dhe baza ligjore

Strategjia për Sigurimin e Cilësisë është dokument refererimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe marrëdhënieve të Universitetit me institucione dhe aktorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë. Strategjia për Sigurimin e Cilësisë përshkruan politikën, strukturat dhe elementët që garantojnë cilësinë në Universitetin European të Tiranës.

Strategjia për Sigurimin e Cilësisë bazohet në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore në zbatim të tij, Kodin e Cilësisë, standardet dhe udhëzuesit për sigurimin e cilësisë në Hapsirën Europiane të Arsimit të Lartë (European Standard and Guidelines, ESG 2015), Statutin dhe Rregulloren e UET.

1.2. Vizioni dhe misioni i institucionit

Vizioni i Institucionit

UET synon të ofrojë edukim dhe kërkim të standardeve të krahasueshme me tregun european të edukimit, duke sjellë së bashku stafin, studentët dhe ish-studentët, fakultetet, departamentet dhe njësitë kërkimore që funksionojnë si pjesë e Iniciativës Europiane për Edukim. E gjithë veprimtaria e UET do të zhvillohet në mënyrë që të përfitojë e gjithë shoqëria, në shkallë lokale, kombëtare dhe më gjerë.

Misioni

Të ofrojë një edukim cilësor, i përkthyeshem në kërkim shkencor domethënës; mundësi për të përfituar njohuri nëpërmjet mësimdhënies, krijimtarisë, arritjeve shkencore, gjithashtu nëpërmjet partneriteteve me tregun e punës.

POLITIKA PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Politika për Sigurimin e Cilësisë, është tërësia e qëllimeve, parimeve dhe rregullave që i përmbahet UET për vendimmarrjen dhe planifikimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij.

2.1. Objektivat strategjikë

Nëpërmjet Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin Europian të Tiranës, synohet:

- ✓ Të promovohet kultura e cilësisë sipas së cilës çdo anëtar i komunitetit të Universitetit e shoh sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë si përgjegjësi individuale dhe tërësore;
- ✓ Të zhvillohen politika, procedura dhe procese të cilat mbështesin një cikël efektiv të planifikimit, zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të veprimtarisë në përputhje me vizionin dhe misionin e Institucionit;
- ✓ Të krijohet tabloja e qartë dhe reale e cilësisë në momentin e dhënë sipas qasjeve; “*cilësia si përputhje me misionin, qëllimin*” e cila nënkupton cilësinë si përmbushje të misionit të institucionit dhe të qëllimit të një programi studimi, të objektivave të vendosur, të një rezultati të pritshëm, dhe “*cilësia bazuar në standarde*”, e cila nënkupton cilësinë si përmbushje të standardeve shtetërore të cilësisë që lejojnë një shkallë të krahasimit;
- ✓ Të përvetësohet në mënyrë optimale aplikimi i standardeve të sigurimit të cilësisë dhe praktikave më të mira, veçanërisht ato të trendeve të Hapsirës Europiane të Arsimit të Lartë;
- ✓ Të sigurohet gjithëpërfshirja dhe kontributi i palëve të interesuara nëpërmjet komunikimit dhe publikimit të informacionit dhe vendimmarrjeve.

2.2. Parimet e menaxhimit të cilësisë

UET bazohet në parimet e ISO 9001-2015 për të ndërtuar paketën e menaxhimit të cilësisë të përqëndruar në zhvillimin efektiv, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe procedurave të cilësisë.

Parimi 1: Studenti në fokus. (Student Centred approach). Ky parim nënkupton përfshirjen e studentëve përmes marrëdhënieve proaktive student-staf, qasjeve të mësimnxënies aktive dhe mekanizmave transparente dhe llogaridhënëse të mbështetjes së tyre. Studentët duhet ta ndiejnë që zëri i tyre dëgjohet, që ata kontribuojnë në procesin e të nxënies dhe ndajnë eksperiencat e tyre me të tjerët, si edhe e ndiejnë veten pjesë të institucionit. Zbatimi i këtij parimi të cilësisë është thelbësor dhe i shërben suksesit afatgjatë të Institucionit.

Parimi 2: Lidërsia. Ky parim nënkupton se orientimi i veprimtarisë së UET sipas një vizioni, misioni dhe objektivave të zhvillimit, ndihmon procesin e sigurimit të cilësisë dhe kërkon që sistemi i menaxhimit të cilësisë të ndërtohet në përputhje me to.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



Parimi 3: Gjithpërfshirja e individëve. Të gjithë anëtarët e komunitetit të UET kërkohet të përfshihen në sigurimin e cilësisë duke i respektuar ata, pasi në këtë mënyrë secili jep kontribut në përbushjen e cilësisë, por shpreh edhe përgjegjshmërinë individuale dhe tërësore në këtë proces.

Parimi 4: Qasja ndaj procesit. Ndërlidhja e të gjithë veprimtarive të UET dhe funksionimi si një sistem brenda Institucionit, ndihmon në optimizimin e proceseve dhe arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe të mirëpërcaktuara.

Parimi 5. Përmirësimi. Në epokën e sotme të ndryshimeve të shpejta, suksesi është i lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm. Përmirësimi është i rëndësishëm për Institucionin për të ruajtur nivelin e arritur të performancës, për të reaguar ndaj ndryshimeve dhe për të krijuar mundësi të reja zhvillimi dhe niveli më të lartë cilësie.

Parimi 6. Vendimmarrja bazuar në evidencë. Sipas këtij parimi, faktet, evidencat dhe analiza e të dhënave, bëjnë të arrihet një shkallë e lartë e objektivitetit në marrjen e vendimeve, të merren vendime të mira që prodhojnë rezultate të dëshiruara.

Parimi 7. Menaxhimi i marrëdhënieve. Sipas këtij parimi, palët e interesuara ndikojnë në performancën e Institucionit. Suksesi i qëndrueshëm arrihet kur Institucioni menaxhon marrëdhëniet me palët e interesuara për të optimizuar ndikimin e tyre në performancën e tij.

2.3. Standardet e sigurimit të brendshëm të cilësisë

UET i përmbahet Standardeve të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të zbatueshme në Hapsirën Europiane të Arsimit të Lartë (ESG), të miratuara nga Konferenca Ministeriale (Maj, 2015).

Standardi 1. Politika për sigurimin e cilësisë.

Institucioni duhet të ketë një politikë për sigurimin e cilësisë e cila është bërë publike dhe është pjesë e menaxhimit strategjik. Palët e interesuara brenda institucionit duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë këtë politikë nëpërmjet strukturave dhe proceseve të përshtatshme duke përfshirë edhe palët e interesuara jashtë institucionit.

Standardi 2. Hartimi dhe miratimi i programeve.

Institucioni parashikon procese për hartimin dhe miratimin e programeve të studimit që ofron. Programet e studimit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të përbushin objektivat dhe rezultatet e të nxënësve. Diploma e dhënë për programin e studimit duhet të përputhet me nivelin e kornizës kombëtare dhe asaj europiane të kualifikimeve.

Standardi 3. Të nxënësit, mësimdhënia dhe vlerësimi me në qendër studentin.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



Institucioni garanton se programet zhvillohen në mënyrë të tillë që nxisin studentët të luajnë një rol aktiv në krijimin e procesit të të nxënit dhe se vlerësimi pasqyron këtë qasje.

Standardi 4. Pranimi i studentëve, progresi, njohja e krediteve dhe diplomimi i tyre.

Institucioni duhet të paracaktosh dhe të publikosh rregulla për të gjitha fazat e “jetës studentore”, pranimin, progresin akademik, njohjen e krediteve dhe diplomimin.

Standardi 5. Personeli akademik.

Institucioni duhet të garantojë cilësinë e personelit akademik. Institucioni duhet të zbatosh procedurë të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik.

Standardi 6. Burimet e të nxënit dhe mbështetja për studentin.

Institucioni duhet të ketë fondet e duhura veprimtaritë e të nxënit dhe të mësimdhënies dhe të garantojë se burimet e të nxënit dhe mbështetja për studentin janë të siguruara.

Standardi 7. Menaxhimi i informacionit.

Institucioni duhet të garantojë se mbledh, analizon dhe përdor informacionin e përshtatshëm për menaxhim efektiv të programeve dhe veprimtarive të tjera.

Standardi 8. Informimi i publikut.

Institucioni duhet të publikojë informacion për veprimtaritë që kryen, përfshirë programet e studimit, i cili duhet të jetë i qartë, i saktë, objektiv, i përditësuar dhe lehtësisht i arritshëm.

Standardi 9. Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi periodik i programeve.

Institucioni duhet të monitorojë dhe të vlerësojë periodikisht programet që ofron dhe të garantojë se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve dhe të shoqërisë.

Këto vlerësime duhet të çojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Veprimet e ndërmarra si rezultat i vlerësimit dhe përmirësimit duhet t'u komunikohen palëve të interesuara.

Standardi 10. Sigurimi i jashtëm ciklik i cilësisë.

Institucioni duhet t'i nënshtrohet sigurimit të jashtëm të cilësisë në baza ciklike në përputhje me standardet dhe udhëzimet kombëtare dhe europiane.

STRUKTURAT E SIGURIMIT TË CILËSISË

Universiteti European i Tiranës ka përcaktuar përgjegjësitë funksionale të strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha nivelet. Ato kanë lirinë dhe autoritetin të identifikojnë problemet, të marrin nisma nëpërmjet hartimit të plan-veprimeve, të japin rekomandime dhe të paraqesin zgjidhje për çështje të cilësisë.

Strukturat e sigurimit të cilësisë që veprojnë në Universitet, me anë të bashkëveprimit kanë funksion:

- i) Të ofrojnë mundësi që çështjet, shqetësimet dhe rekomandimet e të gjithë anëtarëve të komunitetit universitar, bashkëpunëtorëve dhe autoriteteve të jashtme, të bëhen të njohura;
- ii) Të garantojnë që të gjithë anëtarët e komunitetit universitar të njoftohen në mënyrë efektive, në kohën e duhur, për vendimet e marra nga organet përgjegjëse;
- iii) Të ofrojnë mundësi dhe hapsirë për të gjithë personelin dhe studentët që të marrin pjesë aktive në procesin e sigurimit të cilësisë.

Parimet, qëllimet dhe objektivat e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në një dokument të veçantë.

Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi, nëpërmjet proceseve të raportimit periodik, vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit.

3.1 Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë

Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UET-it. Nëpërmjet strukturave të brendshme të Universitetit, është vënë në funksion një sistem që ofron performancë dhe i përgjigjet pyetjeve mbi saktësinë dhe efikasitetin e procedurave të sigurimit të cilësisë.

Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional dhe të njësive kryesore. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë fokusohet në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin.

Çdo anëtar i komunitetit të UET, duhet të përmbushë përgjegjësitë që ka për vlerësimin e brendshëm dhe sigurimin e cilësisë në nivel Universiteti, njësie kryesore dhe bazë. Përgjegjësitë dhe të drejtat e individit që vlerësohet në proceset e sigurimit të cilësisë:

- Çdo anëtar i personelit duhet të përcaktojë çdo fillim viti akademik qëllimet dhe objektivat e veprimtarisë së vet në Institucion;
- Çdo anëtar i personelit duhet të informohet me përmbledhjen e vlerësimit të tij;
- Çdo anëtar i personelit duhet të ketë mundësinë e diskutimit dhe ankimit të raportit të vlerësimit për të përpara se ai të arkivohet si dokument përfundimtar i vlerësimit.

Organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional

1. Senati Akademik
2. Bordi i Administrimit
3. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
4. Rektori
5. Drejtoria e Standardeve dhe Cilësisë: Zyra e Kurrikulave

6. Këshilli i Studentëve

Organe, autoritete dhe struktura në nivel të njësive kryesore

1. Dekanati
2. Përgjegjësi i njësisë bazë
3. Përgjegjësi i Grupit Mësimor: Koordinator i programit të studimit
4. Grupet *ad hoc* të vlerësimit të brendshëm

3.2 Akreditimi dhe sigurimi i jashtëm i cilësisë

Strukturat e sigurimit të jashtëm të cilësisë janë:

- autoritetet qeveritare:
 - o Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
 - o Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe,
 - o Bordi i Akreditimit (BA)
- agjenci të hapsirës europiane të sigurimit të cilësisë, pjesë e Rrjetit European të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (European Network of Quality Assurance, ENQA);
- autoritete audituese të pavarura;
- format të tjera të përfshirjes së ekspertëve të jashtëm në sigurimin e cilësisë.

Akreditimi

Akreditimi është procesi nëpërmjet të cilit organi qeveritar, joqeveritar ose privat vlerëson cilësinë e një institucioni të arsimit të lartë ose të një programi studimit në mënyrë që të njohë zyrtarisht plotësimin në një shkallë të caktuar të standardeve të cilësisë. Autoriteti qeveritar përgjegjës për procesin e vlerësimit në kuadër të akreditimit në vendin tonë është Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ndërsa autoritetet joqeveritare/private janë agjenci të tjera kombëtare/ndërkombëtare, pjesë e Rrjetit European të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (ENQA). Autoriteti përgjegjës për njohjen dhe miratimin e akreditimit, bazuar në LAL 80/2015, është Bordi i Akreditimit.

Procedura dhe metodologjia e punës për grupet *ad hoc* të Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimit (GVB), është e përcaktuar në udhëzuesit e agjencive përkatëse; psh. “Manualin për procedurat dhe afatet për vlerësimin në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit” (www.ascal.al). Në çdo rast, në përfundim të procesit të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit, përgatitet sipas udhëzimeve të agjencive përkatëse, në format elektronik (CD) dhe/ose *hard copy*, dosja e vetëvlerësimit (DVV):

- Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB);
- Evidencat në mbështetje të raportit.

Procedura dhe metodologjia e punës për vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit, është e përcaktuar në udhëzuesit e agjencive përkatëse; psh. *“Manualin për procedurat dhe afatet për vlerësimin në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”* (www.ascal.al). Në çdo rast, në përfundim të procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit, universitetit i vihet në dispozicion Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) i hartuar nga ekspertët e përzgjedhur nga agjencia përkatëse për të kryer vlerësimin (Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, GVJ).


Sigurimi i jashtëm i cilësisë

Universiteti përfshihet dhe kryen veprimtari të tjera që lidhen me sigurimin e jashtëm të cilësisë, të cilat janë:

- Vlerësimi periodik vjetor i veprimtarive të Universitetit në përfundim të këtij procesi raportohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit duke u bërë objekt i kontrollit dhe vlerësimit të jashtëm prej këtij organi qeveritar, vlerësimi kryhet sipas procedurave dhe metodologjisë së përcaktuar në aktet nënligjore të MAS;
- Vlerësimi periodik i veprimtarisë së Universitetit në përfundim të këtij procesi raportohet mbështetur në evidenca, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit duke u bërë objekt i kontrollit dhe vlerësimit të jashtëm prej këtij organi qeveritar, vlerësimi kryhet sipas procedurave dhe metodologjisë së përcaktuar në aktet nënligjore komunikimet/kërkesat zyrtare të MAS;
- Universiteti organizon forume/diskutime në rang Fakulteti në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit;
- Universiteti fton ekspertët të jashtëm për konsulta, përfshirje në struktura vendimmarrëse dhe/ose të monitorimit në kuadër të sigurimit të cilësisë.

FUSHA DHE QASJE TË VLERËSIMIT NË KUADËR TË SIGURIMIT TË CILËSISË

Qasja e sigurimit të cilësisë në Universitetin European të Tiranës bazohet në ciklin e përmirësimit të Deming, i njohur si cikli Plan–Do–Check–Act (PDCA), një qasje sistematike që çon në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë sipas skemës:



Fusha të vlerësimit të brendshëm në kuadër të sigurimit të cilësisë janë:

- Programet e studimit dhe mësimdhënia
- Studentët dhe arritjet e tyre
- Personeli dhe performanca e tij
- Kërkimi shkencor
- Shërbimet për studentët
- Menaxhimi i Institucionit

Vlerësimi i programeve të studimit, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të studentëve realizohet sipas qasjes së bazuar në standard.

Vlerësimi i arritjeve të studentëve realizohet bazuar në rezultatet e të nxënit.

Vlerësimi i personelit realizohet në bazë të standardeve dhe treguesëve të performancës.

Vlerësimi i Institucionit realizohet sipas qasjes së bazuar në mision dhe qasjes së bazuar në standarde.

VEPRIMTARI MONITORIMI, VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI

Në funksion të sigurimit të cilësisë, në Universitetin Europian të Tiranës kryhen veprimtaritë e mëposhtme:

Monitoruese

- Monitorim sistematik i respektimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, kritereve të kurrikulave, kritereve të pranimit të studentëve, kritereve të vlerësimit të studentëve, kritereve të pranimit dhe të performancës në punë të personelit, kritereve të menaxhimit të institucionit, kritereve të menaxhimit të burimeve materiale dhe financiare;
- Monitorim sistematik i treguesve të cilësisë së personelit akademik;
- Monitorim sistematik i treguesve të cilësisë së studentëve;
- Monitorim sistematik i treguesve të infrastrukturës.

Vlerësuese

- Vlerësim i arritjeve të rezultateve të të nxënit;
- Vlerësim i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit;
- Vlerësim i programeve të lëndëve (syllabuseve);
- Vlerësim për cilësinë e jetës studentore në UET përmes *focus group*.

Përmirësuese

- Planifikim dhe ndjekja e vazhdueshme e adresimit të gjetjeve nga proceset e monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit (procesi follow-up).

PËRDORIMI I REZULTATEVE

Rezultatet dhe të dhënat e grumbulluara nga proceset e monitorimeve dhe vlerësimeve të kryera në Universitetin Europian të Tiranës në kuadër të sigurimit të cilësisë, përdoren për:

- Planifikimin strategjik të UET;
- Përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit;
- Përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve, mësimdhënies, kërkimit, shërbimeve dhe menaxhimit;
- Planifikimin vjetor të veprimtarive në UET;
- Përmirësimin e performancës së personelit.

Raportet dhe format e tjera të dokumenteve që lidhen me rezultatet e proceseve të monitorimit dhe vlerësimit, arkivohen në mënyrë shkresore ose elektronike. Prandaj, rekomandohet emërtimi, kodimi dhe paraqitja e standardizuar për të gjithë dokumentacionin që lidhet me sigurimin e cilësisë.

KOMUNIKIMI DHE PUBLIKIMI I REZULTATEVE

Universiteti Europian i Tiranës dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe publikimin e rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit, në përputhje me format e miratuara nga Rektorati dhe Senati Akademik.

UET garanton se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë është i përshtatshëm për qëllimin që ka, është i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet në një gjuhë të kuptueshme për të gjitha palët e interesuara. Ky proces mbikqyret nga KSBC në nivel Institucioni dhe informacioni përditësohet rregullisht.

HARTIMI DHE NDRYSHIMI I STRATEGJISË PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Dokumenti i Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë hartohet nga Zyra e Standardeve dhe Cilësisë në bashkëpunim me KSBC-në dhe miratohet nga Senati Akademik i UET. Hartimi dhe ndryshimi i Strategjisë SC është një proces gjithpërfshirës, i hapur dhe transparent.